



QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02 dhe ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 202/24) Nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit për Zjarrfikësit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/04, 81/07, 55/13, 158/14, 193/15, 39/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 152/19), Qyteti i Shkupit, shpall

SHPALLJE PUBLIKE nr. 09/2024

Për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar në vendet e punës të mëposhtme:

1. Zjarrfikës shpëtimtar me shifër POZH0210V04000 në Njësinë Territoriale Zjarrfikëse të Qytetit të Shkupit – Brigada për Mbrojtjen Kundër Zjarrit e Qytetit të Shkupit (BMKZ), Sektori për mbrojtje dhe shpëtim**1 përmbaarues**.

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënsh tetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim me ndalim kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Kushte të veçanta:

- niveli i kualifikimeve profesionale - IV sipas Kornizës maqedonase për kualifikime dhe të ketë fituar 180 kredi ose 240 sipas ECVET ose MKSOO ose të ketë përfunduar të paktën arsimin e lartë ose arsimin e mesëm;
- me ose pa përvojë pune në profesionin e regjistruar në Agjencinë për Punësime si stazh pune.

Kompetenca të përgjithshme pune:

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritja e rezultateve,
- puna me të tjerët/puna ekipore,

- orientimi ndaj palëve të interesuara

Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr. 09/2024, të depozitojnë biografi të shkurtër dhe letër motivimi të shkurtër, si dhe dëshmi të plotësimit të kushteve të mësipërme të punës (në origjinal ose kopje të noterizuar) si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim me ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit dhe
- dëshmi e aftësisë shëndetësore dhe psikofizike të konfirmuar nga institucioni i autorizuar shëndetësor në përputhje me ligjin.

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Zjarrfikës shpëtimtar është 41.721,00 denarë.

Orari i punës është me turne, nga e hëna të dielën, përkatësisht - 12 orë punë, 24 orë pushim, 12 orë punë, 48 orë pushim.

Kandidatët mund ta shkarkojë **Aplikacionin për punësim sipas shpalljes publike nr. 09/2024** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën bul. "Ilinden" nr.82, Shkup.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup, me shënimin - për **SHPALLJE PUBLIKE nr. 09/2024 për punësimin e punëtorëve dhe numrin rendor të vendit të punës për të cilin aplikojnë.**

Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuara në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

Vërejtje: Nëse kandidati në aplikim nuk ka depozituar të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: verifikimi i aplikimeve dhe dëshmive - në afat prej 8 ditësh nga dita e përfundimit të Shpalljes publike, Komisioni përzgjedhës verifikon nëse kandidatët kanë depozituar dëshmitë e detyrueshme për plotësimin e kushteve të shpalljes. Nëse mungon ndonjë dëshmi, do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit në aplikimin e tij në afat prej tri ditësh nga dita e kompletimit të dëshmive, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: verifikimi i aftësive fizike të kandidatëve për punësim të cilët kanë kaluar fazën e parë kryhet nga ana e Komisionit përzgjedhës.

Faza 3: intervistë e kandidatëve të përzgjedhur – realizohet në afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së dytë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës së përzgjedhjes janë rregulluar në mënyrë të hollësishme në Rregulloren për kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim në Njësinë Territoriale të Zjarrfikësve të Qytetit të Shkupit – Brigada për Mbrojtjen Kundër Zjarrit (BMKZ), nr.08-12596/1 datë 19.11.2024, e cila është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit(www.skopje.gov.mk).

Vërejtje: Kandidati i përzgjedhur sipas këtij njoftimi është i detyruar që brenda një viti nga dita e punësimit të pajiset me certifikatën e kualifikimit si zjarrfikës, të lëshuar nga institucioni i autorizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në të kundërt i ndërpritet punësimi.

**QYTETI I SHKUPIT
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT**